



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 2 tetor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadriaj, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa.

Munguan: Sasha Gjokiq, Bahri Thaçi, Flora Brovina, Liburn Aliu.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për kontrollin e duhanit, para miratimit në parim;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të monitorimit të Ligjit të punës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për kontrollin e duhanit, para miratimit në parim

Fikrim Damka- Tha se ne duhet ta shqyrtojmë këtë ligj, para miratimit në parim.

Nazane Breca- Deklaroi se ligji i mëparshëm ka pasur zbrazëti, ndërkaq ky Projektligj ishte i hartuar mirë dhe në parim e mbështes miratimin e tij.

Time Kadriaj- Tha se gjatë hartimit të këtij Projektligji janë marrë për bazë edhe vërejtjet tona që i kemi dhënë gjatë monitorimit të zbatimit të tij. Në parim e mbështes miratimin e këtij Projektligji.

Komisioni unanimitisht vendosi miratimin e Projektligjit për kontrollin e duhanit, para miratimit në parim dhe përcjelljen e tij në seancë plenare për lexim të parë.

3. Shqyrtimi i raportit të monitorimit të Ligjit të punës

Fikrim Damka- Tha se jemi vonuar me këtë raport, me qëllim që të kemi një raport të mirë. Pas punëtorisë që e kemi pasur, janë shtuar edhe disa gjëra.

Salihe Mustafa- Tha se ne duhet të merremi vesh se si do të hartohet raporti, me informata që marrim si grup apo t'i shkruajmë edhe informatat individuale.

Nazane Breca- Tha se, përveç gjetjeve si grup i punës, ne mund të marrim edhe individualisht informata për çështjen në fjalë.

Time Kadriaj- Tha se vërejtjet i kam pasur sa i takon pushimit të lehonisë. Ne nuk kemi hasur në raste që nuk respektohet kjo e drejtë e gruas, ndërkaq në raport thuhet se kemi hasur në diçka të tillë. Kjo nuk e ka vendin në raport, por një gjë e tillë mund të ngrihet në seancë me ministrin përkatës.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që ta shtyjë miratimin e raportit të monitorimit të Ligjit të punës.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka